"Diktatura dhe demokracia në epokën e ekstremeve"

LAURENCE AUER & CHRISTINE ALTHAUSER

52 vjetori i Marrëveshjes së Eliseut: Gjermania dhe Franca bashkërisht për sigurinë, për bashkëpunimin dhe për lirinë e mendimit në Evropë

Përvjetori i Marrëveshjes së Eliseut, që sivjet feston ditëlindjen e 52-të, paraqet shkas për të rikujtuar se çka dëshiruan të arrijnë bashkërisht Franca dhe Gjermania me nënshkrimin e kësaj marrëveshje historike për miqësi.

Sivjet, në Galerinë Kombëtare Çifte Hamam do të shfaqet një rishikim historik i Evropës së shekullit XX përmes fotografive të Institutit Gjerman për Histori Bashkëkohore. Përmes ekspozitës, e cila është titulluar si « Diktatura dhe demokracia në epokën e ekstremeve", tregohet njëqindvjetori nga Lufta e Parë Botërore, 75 vite nga Lufta e Dytë Botërore dhe 25 vite nga rënia e Murit të Berlinit.

Por sivjet, nga 7 janari gjendemi në shok për shkak të vrasjes në Paris të 17 burrave dhe grave të cilët ishin gazetarë, pjesëtarë të policisë ose viktima të pafajshme në supermarket.

Për Francën dhe Gjermaninë është i njohur barbarizmi dhe për këtë arsye vendosëm "kurrë më". Dolëm më të fuqishëm dhe po e ndërtojmë Evropën në shtyllat e saj. Në elanin që na udhëheqë janë të kyçura edhe vendet e Ballkanit Perëndimor dhe jemi të bashkuar duke përsëritur këtë.

Cak i sulmit në Paris ishin gazetarët. Me vite pranonin kërcënime. Ky është momenti i vërtetë të rikujtojmë se liria e mendimit, e drejta për të menduar, ku është përfshirë edhe karikatura dhe

kontroversiteti është e drejtë e garantuar me ligj. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, rikujton se "secili ka të drejtë për liri të shprehjes, kurse kjo e drejtë përfshin edhe lirinë për të përfaqësuar edhe një mendim i caktuar, të pranohen dhe të jepen informata dhe ide pa ndërhyrje të autoriteteve zyrtare dhe pa marrë parasysh kufijtë".

Në botën, e cila duket se po del nga binarët, duhet të punojmë bashkërisht për t'i ruajtur vlerat themelore të Evropës. Në tërë Evropën, populistët tani po e ngrejnë zërin me të cilin mbështesin egoizmin nacional, izolimin dhe jotolerancën. Këtu nuk bëhet fare fjalë për vlera demokratike dhe për vlerat e solidaritetit, që janë trashëguar nga revolucionet për liri nga viti 1789 dhe 1989. bashkërisht jemi të vendosur të ju kundërvihemi demagogëve. Kjo vlen për brenda kufijve tanë por edhe për jashtë tyre: nëse Franca dhe Gjermania nuk qëndrojnë me vendosmëri krah për krahu, atëherë të dy vendet do t'i vuajnë pasojat, kurse bashkë me to edhe shumë vende tjera. Nuk ekziston më "krizë te të tjerët".

Pas sulmit në Paris, Franca dhe Gjermania menjëherë reaguan në suaza evropiane për zbulimin e shkaqeve për këtë akt të pështirë dhe për masat që duhet të ndërmerren. Karakteri momental dhe operativ i mirëkuptimit tonë daton që nga viti 1963, kohë kur vendosëm bashkërisht t'i mbikëqyrim ngjarjet në botë.

Zyra frëngo-gjermane për të rinjtë është arritje e rëndësishme nga Marrëveshja e Eliseut. Duke falënderuar këtë zyrë, gjatë gjithë këtyre dekadave gjermanët dhe francezët mësuan të njihen mirë si asnjëherë më parë. Gjatë Konferencës për Ballkanin Perëndimor që u mbajt në Berlin në muajin gusht të vitit 2014, të gjithë pjesëmarrësit u morën vesh të themelojnë Zyrë për rini për Ballkanin Perëndimor në bazë të modelit Zyrës fringo-gjermane për rini. Dëshirojmë që ky projekt të shënojë të njëjtin sukses sikurse edhe modeli i tij. Që nga viti 2006, "dita për zbulim» është pjesë përbërëse aktiviteteve të Zyrës për rini që realizohet rreth 22 janarit. Qëllimi i tij është që nxënësit nga Gjermania dhe Franca të kenë pasqyrë për botën gjermano-frënge të punës, detyrë e cila nga aspekti i sfidave të integrimit profesional të rinjve gjithandej në Evropë, duke përfshirë edhe Maqedoninë, është me peshë të veçantë. "Dita e zbulimit" duhet të ju mundësojë të personave të rinj që marrin pjesë të kenë perspektivë për jetën e ardhshme profesionale, përmes mësimit të gjuhës së tjetrit dhe duke përfituar aftësi interkulturore. Do të ishim të gëzuar nëse në të ardhmen Zyra për të rinj për Ballkanin Perëndimor u mundëson nxënësve të tërë rajonit të njihen me mundësitë profesionale që i ofrojnë ndërmarrjet në vendet tjera. Partneriteti jonë i afërt bazohet në shtylla të numërta dhe të pazëvendësueshme: binjakëzimi me numër të madh të komunave, tradita e takimeve, tregtia tejkufitare dhe marrëdhëniet intensive ekonomike.

Fotografitë nga ekspozita frëngo-gjermane dëshmojnë për atë se sa beteja ishin të domosdoshme që të garantohet liria dhe demokracia dhe të përmbyten diktaturat e rënda. 52 vjetori na rikujton se këto vlera, në një botë gjithnjë e më të komplikuar, ende e kanë vlerën e tyre.

(Laurence Auer është ambasadore e Francës në Maqedoni. Christine Althauser është ambasadore e Gjermanisë në Maqedoni)